



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË PËR KRIME TË RËNDA

RAPORTI VJETOR I PUNËS SË PROKURORISË
PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA TIRANË
PËR VITIN 2018

HYRJE

E nderuar znj. Prokurore e Përgjithshme,

Në përmbushje të detyrimeve ligjore, të nenit 50 të ligjit nr. 97/2016, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, urdhërit të Prokurorit të Përgjithshëm me nr.330, datë 29.12.2016, “Për përmbajtjen e raportit vjetor të drejtuesit të prokurorisë”, paraqes përpara Prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Shqipërisë, raportin vjetor të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për veprimtarinë e punës, për vitin 2018.

Nepërmjet këtij raporti, do të pasqyrojmë në mënyrë të përgjithshme dhe të detajuar treguesit e punës për periudhën njëvjeçare, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë në vitin 2018, ku në tërësi vihet re një shkallë e lartë përgjegjësie e prokurorëve në përmbushjen e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, në ushtrimin e ndjekjes penale, mbrojtjen dhe përfaqësimit e akuzës në gjykim si dhe kryerjen në tërësi të detyrimeve ligjore.

Si rezultat i punës së tyre, evidentohet rritje e efektivitetit dhe cilësisë së hetimit në ushtrimin e ndjekjes penale, ngritjen dhe mbrojtjen e akuzës në gjykatë, ekzekutimin e vendimeve penale dhe mbikqyrjen e vuajtjes së dënimit, si dhe në ushtrimin e funksioneve të tjera të ngarkuara me ligj.

Sipas strukturës të bashkëngjitur udhërit të Prokurorit të Përgjithshëm, për përgatitjen e raportit vjetor, paraqesim të dhënat si më poshtë:

PËRMBAJTJA

I. Drejtimit dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit në vitin 2018

- Respektimi i të drejtave të njeriut
- Të miturit dhe grupet vunerabël, si të pandehur dhe viktima
- Bashkëpunimi ndërinstitucional
- Bashkëpunimi ndërkombëtar
- Përdorimi i metodave speciale hetimore dhe hetimet proaktive
- Informacion mbi zbatimin e Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm;
- Informacion mbi zbatimin e Rezolutës së Kuvendit dhe planit të veprimit në zbatim të sajë.
- Informacion mbi zbatimin rekomandimeve të KM dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerra në bazë të tyre
- Informacion statistikor mbi çështjet penale që lidhen me procesin e verifikimit të itengritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtronjë funksione publike
- Të dhënat për temat dhe numrin e trajnimeve të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore apo të përbashkëta me Policinë e Shtetit.
- Problematikat e hasura

II. Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së prokurorisë për vitin 2018

- Volumi i punës në hetim
- Çështje të përfaqësuara në gjykatë

- Treguesit kryesorë të punës së prokurorisë
- Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale
- Të dhëna në lidhje me masat e sigurimit personal e pasuror
- Treguesit e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë
- Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale të njësive administrative në kompetencë të prokurorisë
- Kriminaliteti sipas peshës/përhapjes së veprave penale dhe tendencave të tyre
- Kriminaliteti sipas strukturës së Kodit Penal

III. Treguesit statistikorë 2-vjeçarë të veprave penale sipas strukturës së Kodit penal

- Numri i procedimeve të regjistruara, numri i procedimeve të dërguara për gjykim, numri i të pandehurve nën hetim të regjistruar, numri i të pandehurve të dërguar për gjykim, numri i të pandehurve të dënuar

IV. Analiza e treguesve të efektivitetit të punës së Prokurorisë pranë Gjykatës Shkallës Parë për Krime të Rënda.

- Treguesi i efektivitetit në gjykimin dhe denimin e të pandehurve
- Të dhëna për gjykimet e posaçme
- Të dhëna mbi llojet dhe masat e denimeve/ kërkesa e prokurorit dhe vendimet e gjykatës
- Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit, si gjinia, mosha, arsimi, punësimi etj
- Të dhëna për të pandehurit e mitur, numri i procedimeve të regjistruara, numri i procedimeve të dërguara për gjykim, numrin e të pandehurve dhe personave nën hetim të mitur të regjistruar, të dërguar për gjykim, të dënuar, numër procedimesh regjistruar, masa sigurimi e denime të zbatuara, denime alternative etj
- Të dhëna për pasojat e veprave penale

V. Të dhëna lidhur me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja

- Ekstradime
- Letër porositë, nga jashtë, komisione rogatore dhe dorëzime të kontrolluara, letër porositë për jashtë
- Njohjet e vendimeve penale, njohjet e vendimeve penale të huaja dhe njohjet e vendimeve penale shqiptare jashtë vendit
- Transferimet e procedimeve penale
- Transferimet e personave të dënuar
- Shpalljet në kërkim ndërkombëtar, heqjet nga kërkimi ndërkombëtar

VI. Të dhënat për ngarkesën e punës për çdo prokuror dhe oficer të policisë gjyqësore

VII. Informacion mbi administrimin e prokurorisë

- Përfshirë zbatimin e buxhetit, marrëdhëniet me mediat dhe publikun, rregullsia e mbajtjes së regjistrave, kapacitetet infrastrukturore dhe siguria, respektimi i disiplinës në punë dhe etikës nga punonjësit.

VIII. Drejtimit dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit për vitin pasardhës dhe rekomandime

I. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2018

Për vitin 2018 Prokuroria Pranë Gjykatës Shkallës Parë për Krime të Rënda Tiranë, ka pasur për qëllim përmbushjen e detyrimeve kushtetuese dhe ligjore në ushtrimin me efikasitet të ndjekjes penale, rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së hetimit, mbrojtjes dhe përfaqësimit të akuzës në gjykim si dhe kryerjen në tërësi të detyrave të ngarkuara me ligj, akte nënligjore, urdhëra dhe udhëzime që normojnë dhe rregullojnë punën për mirëfunksionimin e prokurorisë. Në zbatim të ligjit me nr.97/2016 të vitit 2016 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 21 të këtij ligji, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm Nr 1 datë 20.02.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm, “Për krijimin e seksioneve të posaçme” kjo prokurori u riorganizua në tre seksione për ndarjen e punës, duke krijuar seksione të veçanta me prokuror dhe officer të policisë gjyqësore, për grup vepra penale, në kompetencë lëndore të kësaj prokurorie.

Në zbatim të Udhëzimit nr 1, datë 20.02.2018 “Për krijimin e seksioneve të posaçme” të Prokurorit të Përgjithshëm, ju bëj me dije se me Urdhërin nr 34 datë 02.07.2018, të Drejtuesit të Prokurorisë së Krimeve të Rënda është ngritur seksioni i posaçëm i përbërë nga pesë prokurorë, të cilët referuar të dhënave të administruara nga Prokuroria e Përgjithshme i janë nënshtruar një verifikimi paraprak të pasurisë figurës dhe anës profesionale. Prokurorët që kanë bërë pjesë në këtë seksion për vetë natyrë e veprave penale që hetojnë janë pjesë dhe e seksionit të hetimit të veprave penale të Korrupsionit si dhe e hetimit pasurorë në zbatim të Ligjit Antimafia. Referuar seksionit të posaçëm, ky seksion ka trajtuar materialit e referuar nga struktura Forca e Ligjit pranë Drejtorisë Qendrore të Policisë Tiranë.

Ndarja në seksione i ka shërbyer pikërisht mundësisë së përqëndrimit të grupveprave penale në seksione të veçanta ku grupveprat penale të trafikimit të narkotikëve, njerëzve, veprave penale me qëllime terroriste edhe kur ato kryhen në forma të veçanta të bashkëpunimit u përqëndruan në një seksion të veçantë, grupveprat penale të korrupsionit edhe kur ato kryhen në formën të veçanta të bashkëpunimit si dhe hetimi pasuror u përqëndrua në një seksion të veçantë si dhe veprat penale të tjera edhe kur ato kryhen në formën e veçantë të bashkëpunimit, ekzekutimet e vendimeve, shqyrtimi i letër-porosit nga jashtë u përqëndruan në një seksion të veçantë.

Prokuroria Pranë Gjykatës Shkallës Parë për Krime të Rënda në fokusin e aktivitetit të saj ka patur përqëndrimin dhe angazhimin e prokurorëve dhe policisë gjyqësore për përfundimin sa më shpejtë të hetimeve për çështje të mbartura nga vitet e kaluara, hetime të cilat përfshinin çështje me grupe të strukturuar kriminale, të korrupsionit, procedime pasurore, si dhe çështje për vepra penale të tjera, në kompetencë të kësaj prokurorie.

Ndër përparësitë e punës, ka qenë kërkësa për fillimin kryesisht të procedimeve penale në rastet e ardhjes në dijeni në çdo formë për veprat penale të korrupsionit dhe krimin të organizuar si dhe intensifikimi i bashkëpunimit me strukturat ligjzbatuese në vend për të krijuar një frymë më të mirë bashkëpunimi në luftën e përbashkët kundër këtyre fenomeneve të cilat vazhdojnë të kenë përhapje të gjërë në vendin tone.

Në fokus të punës së prokurorisë ka qënë dhe është ndërshkimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke rritur standartet e procedimit, rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së hetimit dhe të mbrojtjes dhe përfaqësimit të akuzës në gjykim, ashpërsimi i llojeve dhe masave të denimit për kategori të caktuara të veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Rastet e trafikimit të narkotikëve, kanë qënë në qëndër të vemëndjes dhe punës së prokurorisë. Këto raste u paraqiten në forma dhe rrugë të ndryshme të trafikimit, nëpërmjet rrugëve detare, pikave të kalimit kufitar ku një numër i madh rastesh dhe sasira narkotikësh arriti të trafikohet jashtë vendit duke u identifikuar nga autoritetet e vendeve të tjera, kryesisht në Itali, Greqi, Gjermani etj. Në këto raste, pasi kemi konfirmuar vertetësinë e tyre dhe faktin se burim trafikimi ishte vendi ynë, në bashkëpunim me policinë e shtetit kemi filluar procedime penale dhe vijojnë hetimet për secilin rast, të cilat janë në numër të konsiderueshëm. Numri më i madh i këtyre çështjeve janë për trafikimin e lëndës narkotike cannabis sativa ndërsa ka dhe raste me trafikim të drogave të tjera, këto të fundit në pikat e kalimit kufitar.

Hetimet e çështjeve të trafikimit të kaluara në pikat e kalimit kufitare, u paraqiten të veshitura dhe komplekse rezultojnë të jenë kryer në mënyra shumë të sofistikuar ku për disa nga çështjet për të cilat vazhdon hetimi intensiv duke kryer hetime të përbashkëta dhe shkëmbyer të dhëna me prokuroritë e vendeve tjera, kryesisht në Itali, Greqi, Gjermani dhe më gjerë.

Edhe në rastet e trafikimit të narkotikëve të kapura në flagrance, ku numrin më të madh të tyre zënë rastet e paraqitura në pikat e kalimit kufitar të vendit tonë, po kryhen hetime pa u kufizuar tek personat e arrësuarit në flagrance, (transportuesit) për identifikimin dhe vënien para përgjegjesisë të bashkëautorëve të tyre. Në këtë kontekst rëndësi e veçantë i është kushtuar shkëmbimit të informacionit me vendet fqinje të cilat do të shërbenin si pikë transit apo destinacion të trafikut. Ndërkohë po vijojnë hetimet proaktive për çështje të regjistruara për trafikim narkotikësh dhe grupe të strukturuar kriminale që operojnë në këtë aktivitet të kundërligjshëm.

Ndër përparësitë e punës dhe në vemëndje ka qënë ushtrimi i ndjekjes penale për veprat penale të korrupsionit të zyrtarëve të lartë si dhe të zgjedhurve vendore si dhe në sistemin e drejtësisë, ku përveç punës në drejtim të përfundimit të çështjeve në hetim, kemi bërë përpjekje që të gjitha rastet për të cilat kemi marrë informacion të fillonin hetimet kryesisht dhe në bashkëpunim me strukturat ligjzbatuese në vend, kryesisht policinë e shtetit. Është vijuar me përfundimin e hetimeve për çështjet në hetim, disa prej të cilave janë dërguar për gjykim si dhe janë regjistruar kryesisht dhe me referim disa çështje për të cilat po behën hetime.

Përparësi i është kushtuar dhe veprave penale me qëllime terroriste dhe në mënyrë të vazhdueshme raste të dyshuara janë diskutuar me strukturat ligjzbatuese në vend dhe me ndihmën dhe asistencën e partnerëve ku për vitin 2018, janë regjistruar 4 procedime penale dhe bashkë me procedimet e mbartura u hetuan gjithsej 10 procedime penale.

Në fokus të punës së seksionit përkatës ka qënë dhe evidentimi, dokumentimi, sekuestrimi dhe konfiskimi i pasurisë në kuadër të ligjit me nr.10192 datë 03.12.2009, *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”* (ndryshuar me ligjin nr.24/2014, datë 20.3.2014, nr.70/2017, datë 27.4.2017). Në këtë prokurori ndër vite, janë akumuluar një numër i konsiderueshëm i materialeve dhe i procedimeve pasurore, ku për vitin 2018, janë trajtuar 774 raste të hetimit pasuror nga të cilët, për 13 referime pasurore është vendosur mosfillim i tyre, ndërsa pjesa tjetër e materialeve pasurore rreth 761 janë mbarten për vitin 2019. Duhet theksuar se gjatë këtij viti me kërkesë të prokurorisë janë vendosur sekuestro dhe janë konfiskuar, kryesisht

pasuri të paluajtshme dhe vlera monetare, të cilat janë paraqitur më hollësisht në tabelat përkatëse pjesë e këtij raporti. Tabela nr.16 dhe nr.17.

Respektimi i të drejtave të njeriut

Gjatë ushtrimit të ndjekjes penale një rëndësi e veçantë i është kushtuar garantimit dhe respektimit të të drejtave të njeriut, duke respektuar garancitë procedurale të personave nën hetim dhe të pandehurve, të lirë ose të arrestuar, garantimin e mbrojtësit në rastet e detyrueshme, njoftimin e akteve në përputhje me garancitë proceduriale të personave nën hetim, të pandehurve dhe mbrojtësve të tyre etj. Po ashtu e njëjta rëndësi i është kushtuar repektimit të këtyre garancive dhe të drejtave proceduriale të parashikuara me ndryshimet e pësuara në Kodin e Procedurës penale, hyrë në fuqi në muajin Gusht të vitit 2017.

Të miturit dhe grupet vulnerabël, si të pandehur dhe viktima

Mbrojtja e të drejtave të të miturve ne procesin penal ka qenë në vemëndjen e vazhdueshme të punës së prokurorëve në hetimin e çështjeve me të mitur, duke respektuar me rigorozitet urdherat dhe udhëzimet e mëparshëm të Prokurorit të Përgjithshëm *“Për hetimin e veprave penale ku i mituri përfshihet si i pandehur person nën hetimi, i dëmtuar ose dëshmitar”*. Është siguruar pjesëmarrjen e psikologut gjatë hetimit si dhe është ruajtur sekreti i informacionit dhe ndalimi i publikimit të akteve hetimore të mbledhura nga policia gjyqësore lidhur me provat e mbledhura për hetimin në ngarkim të të pandehurve të mitur.

Me hyrjen në fuqi të ligjit me nr.37/2017 *“Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”* i cili parashikon rregullime të posaçme lidhur me ndjekjen penale, përgjegjesinë penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të denimit, rehabilitimin si dhe rastet kur i mituri është viktimë ose dëshmitar i veprës. Gjykata e Shkallës Parë për Krime të Rënda nuk ka seksion të veçantë për të miturit, por lind e nevojshme që rastet me të mitur të mund të trajtohen nga prokurorë që janë trajnuar dhe marrin trajnime dhe specializohen për të njohur mire këtë proces. Po ashtu një rol të veçantë dhe prioritet kanë patur në trajtim personat e klasifikuar si viktima të trafikimit, të mitur, femra të cilët janë identifikuar si viktima të trafikimit, për shfrytëzim të ndryshëm, duke iu krijuar asistence ligjore dhe me psikolog si dhe duke marrë masa sociale dhe institucionale për strehimin dhe riintegrimin afatgjatë të këtyre personave, si viktimë të trafikimit.

Bashkëpunimi Ndërinstitucional

Në përmbushjen e veprimtarisë së punës, një rol të rëndësishëm ka dhe bashkëpunimi me institucionet dhe strukturat ligjzbatuese në vend, veprimtaria e të cilave është e lidhur ngushtë me punën e kësaj prokurorie. Në këto marrëdhënie rol me rëndësi kanë pasur marrëdhëniet me Prokurorinë e Përgjithshme, kryesisht me drejtorinë e marrëdhënjeve juridiksionale me jashtë. Kjo drejtori luan rol të rëndësishëm në krijimin e raporteve të komunikimit dhe koordinimit të marrëdhënjeve juridiksionale me jashtë. Prokuroria për Krime të Rënda aktivitetin e punës së saj në luftën kundër krimit të organizuar e ka të lidhur ngushtësisht, shkëmbimin e të dhënave me Autoritet e huaja të Drejtësisë dhe e ka shumë të nevojshme mbështetjen nga kjo drejtori.

Vlen të përmendet këtu nënshkrimi i tre marrveshjeve për krijimin e skuadrave të përbashkëta hetimore, për hetimin e çështjeve të veçanta me Prokuroritë e Barit, Bergamos dhe Firences në Itali, si dhe zgjatja dhe të një afat tjetër një-vjeçar e marrveshjes së nënshkruar me Prokurorinë e Barit në vitin 2017. Po kështu kemi kërkesa dhe jemi në fazë shqyrtimi dhe të nënshkrimit të marrveshjeve të tjera, mbi bazën e kërkesës së disa Prokurorive të Shtetit Italian.

Një raport i vazhdueshëm komunikimi, bashkëpunimi dhe diskutimi është mbajtur me Prokurorinë e Apelit për Krime të Rënda ku në raste të ankimeve ndaj vendimeve për çështje komplekse dhe me dinamikë hetimi, me qëllim që qëndrimet e prokurorëve të apelit të ishin sa më korrekte dhe të plota është diskutuar mbi aktet dhe bazueshmërinë e ankimeve të prokurorëve të shkallës parë dhe provave të paraqitura. Evidentojmë se komunikimi ka qënë gjithnjë në frymën e mbështetjes së ankimeve ku rezulton se nuk ka pasur heqje dorë nga ankimet për periudhën në fjalë.

Raportet me Gjykatën e Shkallës Parë për Krime të Rënda, kanë qënë korrekte dhe ligjore duke u bazuar në korrektesën e ndërsjelltë dhe reciproke, duke u paraqitur korrekt dhe në mënyre etike në përfaqësimin tonë në gjykim si dhe duke ruajtur etiken dhe solemnitetin në seanca gjyqësore dhe në përgjithësi korrekt me pjesëmarrjen në gjykim. Evidentojmë se ka pasur raste të shtyrjes së seancave për mosparaqitjen e prokurorëve për të cilat gjykata konform ligjit ka njoftuar Drejtuesin e Prokurorisë. Nga verifikimet rezulton se pjesa më e madhe e shtyrjeve të seancave gjyqësore për mungesë të prokurorëve vjen për shkaqe pamundësie objektive të prokurorëve për t'u paraqitur në gjykim si rrjedhojë e angazhimeve të justifikuara kryesisht pjesmarrje në trajnime të ndryshme. Në këtë drejtim lind e nevojshme në të ardhmen një marrëdhënie mirëkuptimi e ndërsjelltë mes prokurorëve dhe gjyqtarëve, që prokurorët të njoftojnë gjykatën paraprakisht për pamundësinë e paraqitjes në gjykim dhe për shkaqet e mosparaqitjes dhe një mirëkuptim i gjykatës për të mos caktuar seanca, kur njoftohen paraprakisht në séance nga prokurorët për pamundësinë e paraqitjes në séancën e ardhshme për shkak të angazhimeve të tjera të planifikuara më parë.

Raportet me Policinë e Shtetit, Prokuroria Pranë Gjykatës Shkallës Parë për Krime të Rënda ka vlerësuar gjithnjë të rëndësishme dhe ka qënë e angazhuar për të krijuar një frymë shumë të mirë dhe të ngushtë bashkëpunimi me të gjitha strukturat e policisë në të gjitha nivelet. Bashkëpunimi ka qënë në nivele shumë të mira me strukturat në DPP Shtetit dhe me disa drejtori vendore.

Është vënë re rritje e vullnetit për t'u bërë pjesë e hetimit të veprave penale në kompetencë të kësaj Prokurorie, kryesisht ka një rritje të referimit të veprave penale të krimit të organizuar, kryesisht në trafikimin e narkotikëve dhe trafikimin e personave. Edhe rastet e referuara nga drejtoritë vendore të policisë në rastet e hetimeve proaktive kanë qënë të inicuar dhe nxitura nga strukturat e DPP Shtetit, si dhe kanë referuar rastet e trafikut të narkotikëve të evidentuara jashtë vendit me burim vendin tone, kapjet në flagrance nga policitë kufitare dhe rastet e nxitura nga informacionet e SHISH. Duhet theksuar se në të gjitha rastet e hetimeve të referuara nga policia e shtetit, u janë deleguar atyre veprimet hetimore.

Për vitin 2018 janë referuar për hetime 54 referime nga DPP Shtetit pra 24 më shumë se në vitin 2017, 89 referime nga të gjithë DPVendore nga 36 të referuar në vitin 2017, 7 referime nga SHÇBA ndërsa janë filluar kryesisht 19 procedime penale nga 13 të filluara kryesisht në vitin 2017, procedime penale janë filluar duke shfrytëzuar dhe duke shfrytëzuar informacione të SHISH etj.

Pamvarësisht nga theksi që vumë më lart për rritjen e nivelit të bashkëpunimit me strukturat qendrore dhe lokale të policisë e konsiderojmë të nevojshme se ka vend për përmirësime ky bashkëpunim si e vetmja mundësi për të përballuar sfidat në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit si dhe të një hetimi pasuror efikas dhe me rezultate konkrete. Evidentojmë kohët e fundit se ka një angazhim dhe vullnet të të gjithë strukturave të policisë vendore dhe qendrore në drejtim të bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës me këtë prokurori. Duhet

theksuar se bashkëpunimi me këto struktura nuk është thjesht çështje vullneti dhe aksioni por si detyrim ligjor pasi gjen zbatim dhe orientohet në akte ligjore dhe nënligjore, si dhe urdhërat dhe udhëzimet ekzistuese të Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrisë të Brendshme.

Bashkëpunimi Ndërkombëtar

Për shkak të veprimtarisë së punës, kompetencës lëndore të kësaj prokurorie, hetimi i veprave penale të krimit të organizuar, kryesisht të trafikimit të narkotikëve dhe të njerëzve, hetimit pasuror, ekzekutimit të letërporosive lidhet ngushtë me marrjen dhe shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve me autoritetet gjyqësore të huaja. Në vijimsi kjo prokurori ka mbajtur një komunikim të vazhdueshëm me Drejtorinë e Mardhëdhënies Juridiksionale me Jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme dhe Ministrinë e Drejtësisë si dhe në shumë raste kur gjëjnë rregullim ligjor, janë krijuar dhe raporte komunikimi të drejtëpërdrejta për shkëmbimin e të dhënave në kohë reale.

Në këtë kuadër, nëpërmjet Drejtorisë së Marrëdhënjeve Juridiksionale me Jashtë janë marrë në shqyrtim dhe ekzekutuar një sërë letër-porosis nga Autoritetet e Huaja të Drejtësisë të vendeve të ndryshme, duke bërë të mundur shqyrtimin dhe ekzekutimin në kohë të tyre, si dhe është kërkuar me letër porosi dhe kërkesa, kryerja e një sërë veprimesh hetimore dhe procedurale jashtë vendit, të cilat përshkruhen në numër në pjesën të këtij raporti. Po ashtu një raport i vazhdueshëm komunikimi është mbajtur dhe për shpalljen e kërimit ndërkombëtar të personave me masa sigurimi dhe të denuar.

Bashkëpunimi ndërkombëtar ka njohur risi të reja, ku pas nënshkrimit të një marrëveshje bashkëpunimi për krijimin e dy skuadrave të përbashkëta hetimore me Prokurorinë e Leçe-s në Itali në vitin 2016 edhe me Prokurorinë e Barit, Itali në vitin 2017, është nënshkruar marrëveshje e përbashkët për zgjatjen e afatit të skuadrës së përbashkët hetimore dhe një vit me Prokurorinë e Bari-t në Itali. Ndërsa janë nënshkruar dhe tre marrëveshje të reja për krijimin e skuadrave të përbashkëta hetimore në procedime penale të veçanta me Prokuroritë e Barit, Bergamos dhe Firences Itali. Në të katër rastet bëhet fjalë për vepra penale të trafikimit të narkotikëve me përfshirje të grupeve të strukturuar kriminale me shtetas shqipëtar dhe Italian me aktivitet kriminal në Shqipëri, Itali, por dhe në vende të tjera të Evropës. Ndërkohë që për njërin nga procedimet penale atë të marrëveshjes së Lecces hetimet janë drejt përfundimit me disa shtetas shqipëtar dhe Italian të arrestuar në dy vendet, ndërsa vazhdon hetimi për procedimin tjetër dhe priten rezultate konkrete në goditjen e grupeve të strukturuar kriminale që eporojnë në fushën e trafikimit të narkotikëve, kryesisht të lëndës narkotike cannabis sativa.

Bashkëpunimit ndërkombëtar i kanë dhënë rendësi me ndihmën e tyre dhe shumë organizma dhe projekte si OPDAT, PAMECA, GIZ, SELECT etj, të cilët financohen nga SHBA dhe BE. Kjo prokurori ka gjetur mbështetje tek prokurorët dhe ekspertët që asistojnë në këto organizma dhe projekte, duke ofruar asistencë ligjore dhe teknike dhe përvojën e tyre por dhe me mbulimin e financimeve me projekte për kontakte dhe takime të drejtëpërdrejta të prokurorëve të çështjeve me prokuror të vendeve të tjera për rastet e hetimeve të përbashkëta. Janë krijuar takime me prokuror të vendeve të rajonit, si dhe të vendeve të BE, kryesisht të Greqisë, Italisë, Gjermanisë, Belgjikës etj, takime të cilat kanë qënë shumë rezultative në drejtim të orientimeve për kryerjen e hetimeve të përbashkëta si dhe për të dhënat që duhet të shkëmbehen nëpërmjet rrugëve juridiksionale dhe për ekzekutimin e tyre në një kohë të shpejtë.

Këto organizma kanë ndihmuar me projektet e tyre, për trajnime të ndryshme të prokurorëve për vepra penale të krimit të organizuar brenda dhe jashtë vendit, organizimin e vizitave

studimore jashtë vendit dhe me këtë rast gjejmë mundësinë t'i falenderojmë dhe shpresojmë së do vijojë mbështetja në punën e prokurorëve dhe kësaj prokurorie në tërësi.

Përdorimi i metodave speciale hetimore dhe proaktive

Përdorimi i metodave speciale të hetimit si mjete të kërkimit të provës janë evident në këtë prokurori, në hetimin e çështjeve proaktive, kryesisht për veprat penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit, çështjeve me arrestime në flagrancë për marrjen e të dhënave për bashkëautor dhe të burimit të përgatitjes dhe importimit të lëndëve narkotike.

Kjo prokurori ka domosdoshmëri përdorimin e metodave speciale të hetimit, siç janë kryerja e përgjimeve, nepërmjet interceptimit të telefonave, përgjimet në vende publike dhe private, veprimet simuluese, infiltrimi i punonjësit të policies, etj, ku për fat të keq dy mjetet e fundit janë përdorur vetëm në dy raste përgjatë vitit 2018 dhe konkretisht në procedimet penale nr 40 të vitit 2018 dhe 238 të vitit 2017.

Kryesisht për hetimet proaktive, prokurorëve iu ka mbetur e vetmja mundësi vetem përgjimi në ambjente publike dhe private aq here sa krijohet mundësia reale për t'u realizuar si dhe përgjimi i telefonave celular veprime të cilat janë shfrytëzuar maskimalisht në të gjitha rastet e kërkuara. Megjithatë për hetimin e veprave penale në kompetencë të kësaj prokurorie është e nevojshme të kryhen veprime simulimi dhe infiltrimi, nuk janë siguruar dhe ofruar nga strukturat e policisë të cilët kanë dhe kapacitetet e duhura në këtë drejtim. Edhe përgjimi i telefonave celular jo në të gjithë rastet ka dhënë rezultate, për shkak të teknologjisë së zhvillimit ku teknikat aktuale nuk i përgjigjen plotësisht kësaj teknologjie dhe persosmërisë së mjeteve të komunikimit që përdorin personat e përfshirë në aktivitete të kundërligjshme dhe për rrjedhojë dhe marrja e informacionit nga këto mjete është bërë e vështirë.

Për vitin 2018 janë kryer përgjime telefoni, në vende publike, për 145 procedime penale të ndara sipas viteve, (1 procedim penal i vitit 2014, 2 procedime penale të vitit 2015, 7 procedime penale të vitit 2016, 31 procedime penale të vitit 2017, dhe 101 procedime penale të vitit 2018). Në vështrim krahasues në vitin 2017 janë kryer përgjime telefonike për 204 procedime penale.

Për vitin 2018 janë depozituar në gjykatë 1313 kërkesa për përgjime telefonike, ku 451 përgjime janë vendosur me autorizime të prokurorit të vlerësuara në gjykatë, 225 përgjime me kërkesë për lejim përgjimi në gjykatë dhe zgjatje afati të përgjimit për 730 kërkesa në gjykatë. Nga këto kërkesa nuk janë pranuar nga gjykata vetëm 2 kërkesa të cilat janë ankimuar në Gjykatën e Apelit, ku njëra kërkesë e Prokurorit është pranuar ndërsa tjetra është në fazën e shqyrtimit në apel.

Në total për vitin 2018 janë përgjuar gjithsej 2146 paisje fundore (numra telefonikë), nga 2415 numra të përgjuar në vitin 2017 .

Edhe për këtë vit, procedimet penale të regjistruara për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a i K.penal, si dhe ato të lidhura me grupin e strukturuar kriminal, zënë vendin kryesorë më kërkesat për lejim përgjimi telefonik.

Për sa u përket përgjimeve ambientale janë vlerësuar dhe kërkuar në gjykatë, 15 autorizimen për përgjime ambientale, për 7 procedime penale të regjistruara në vitin 2018.

Janë kërkuar në gjykatë, 8 kontrolle banesash dhe vendesh per vitin 2018.

Janë ankimuar në gjykatë, 18 vendime mosfillimi të hetimeve të marra nga Prokurori, nga të cilat janë lënë në fuqi 18 vendime mosfillimi, ndërsa janë proshur vendimet e mosfillimit dhe është urdhëruar fillimi i hetimeve në 2 raste nga gjykata.

Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerra në bazë të tyre

Prokuroria për Krime të Rënda, ka qënë e angazhuar në marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave si dhe të urdhërave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerrë në zbatim të tyre, në lidhje me prioritetet në hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe hetimet pasuror që rrjedhin nga veprat penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit. Është intensifikuar bashkëpunimin ndërinstitucional me organet ligjzbatuese në vend, kryesisht me policinë e shtetit, rritja e numrit të hetimeve proaktive, mundësia e përdorimit efektiv të metodave speciale të hetimit, rritja e numrit të hetimeve pasurore, ashpërsimi i politikës penale për denimet, sekuestrimet dhe konfiskimet e pasurive për veprat penale të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Në zbatim të Udhëzimit nr 1, datë 20.02.2018 “ Për krijimin e seksioneve të posaçme” të Prokurorit të Përgjithshëm, juu bëj me dije se me Urdhërin nr 34 datë 02.07.2018, të Drejtuesit të Prokurorisë së Krimeve të Rënda është ngritur seksioni i posaçëm.

Për sa u përket Udhëzimeve të tjera si:

-Udhëzimit nr 4, datë 26.10.2018 “Për përgjimet”.

-Udhëzimit nr 3 datë 26.10.2018, “Për vlerësimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar “ sektor shtetërorë”.

-Udhëzimit nr 5 datë 26.10.2018, “ Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprës penale”.

-Udhëzimi i përgjithshëm nr 6, datë 20.11.2018” Për hetimin pasuror skuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale”, ju informojmë se:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Tiranë, për vetë specifikën dhe kompetencën lëndore që ka i ka kushtuar rëndësi udhëzimeve të detyrueshme të karakterit të përgjithshëm të Prokurorit të përgjithshëm. Sa më sipër me qëllim zbatimin me korrektesë të tyre nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë janë marrë masat e nevojshme dhe konkretisht:

-Të gjitha udhëzimet janë shpërndarë për njohje dhe zbatim prokurorëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore kundrejt nënshkrimit nga sekretaria e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, mbi bazën e shënimeve të drejtuesit.

-Të gjitha udhëzimet janë diskutuar në mbledhje të veçanta me prokurorë dhe oficerë të policisë gjyqësore të organizuara nga Drejtuesi i Prokurorisë së Krimeve të Rënda.

-Në lidhje me udhëzimin nr 4 datë 26.10.2018 “ Për përgjimet”, është kërkuar nga Prokurorët zbatimi me korrektesë i dispozitave ligjore në lidhje me vepra penale dhe subjektet për të cilat lejohet përgjimi, ruajtja sekret e të dhënave që rezultojnë nga përgjimi si dhe pasyrimi i të dhënave në regjistrin e përgjimeve. Në lidhje me pasyrimin e të dhënave në regjistrin e përgjimeve nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë, nga komunikimi me Prokurorin e ngarkuar me mbajtjen e regjistrit të përgjimeve është konstatuar se ka mangësi pasi prokurorët nuk pasqyrojnë në regjistër shënimet përkatëse.

Është lënë detyrë prokurorëve për plotësimin e të dhënave të regjistrit të përgjimeve, dhe po kështu është lënë detyrë shëfit të seksionit që ka në varësi prokurorin që mbanë regjistrin e

përgjimeve të bëjë kontrollin dhe verifikimin e plotësisht me korrektesë të të dhënave të përgjimit.

-Në lidhje me zbatimin e Udhëzimit nr 3 datë 26.10.2018 “Për vlerësimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar shtetërorë” nga ana jonë janë marrë këto masa:

Është bërë verifikimi i kushteve të ruajtjes së informacionit, ku rezulton se pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, ka një regjistër të regjistrimit në hyrje dhe dalje të materialeve sekrete, materialet ruhen dhe administrohen në kasafortë konform rregullave. Po kështu personat e ngarkuar me ruajtjen dhe administrimin e materialeve sekrete është kërkuar të jenë të paisur me çertifikatë sigurie. E njëjta gjë është kërkuar dhe për oficerët dhe prokurorët që njihen me materiale sekrete për shkak të punës, ku ka rezultuar se disa nga ata kishin çertifikatë sigurie, ndërsa një pjesë të tyre u kishte mbaruar afati i çertifikatës.

Për sa i përket Udhëzimeve me karakter jo detyrues, për çështje konkrete, në zbatim të nenit 43/b dhe 48 të Ligjit nr.97/viti 2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, nga ana ime janë nxjerrë 5 te tilla për të cilat pothuajse nuk ka patur kundërshtim lidhur me to, dhe prokurorët e çështjeve nuk kanë paraqitur qëndrim me shkrim lidhur me udhëzimet. Udhëzimet e nxjerra nga ana ime (për shkak të ngarkesës shumë të madhe që ka kjo prokurori) janë nxjerrë kryesisht për procedime penale të cilat kanë patur problematika në drejtim të zvarritjeve, plotësisht të hetimeve, etj. Rastet e tjera janë diskutuar verbalisht me prokurorët dhe duke qenë se kam gjetur dakordësinë e tyre nuk kam vlerësuar të arsyeshme të ndërhyj me udhëzim.

Po kështu me cilësinë e drejtuesit është kërkuar informacion për ecurinë e hetimeve, kryesisht për procedimet penale me persona të arrestuar apo dhe procedime penale të konsideruara me zvarritje mbi 2 vjet në hetim, me qëllim marrjen e masave për përsheptimin e punës dhe përfundimin e hetimeve.

Në lidhje me Udhëzimin e përgjithshëm nr 6, datë 20.11.2018” Për hetimin pasurorë skuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale”, ju informojmë se janë marra masa për zbatimin e tij. Konkretisht, pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda është ngritur Seksioni i hetimit të veprave penale të Korrupsionit si dhe i hetimit pasurorë. Ky seksion kryen hetimin pasurorë të subjekteve të dënuar në fushën e zbatimit të Ligjit Antimafia. Për subjektet që janë në hetim penal, në zbatim të udhëzimit hetimi pasurorë i tyre është caktuar të kryhen nga prokurorët që ndjekin hetimin penal.

Në Prokurorinë e Krimeve të Rënda ka një regjistër të regjistrimit të materialeve të hetimit pasurorë, i cili është i plotë dhe pasyron të gjitha të dhënat ashtu sikurse kërkohet në udhëzim.

Nga Prokuroritë e Rretheve në zbatim të udhëzimit të sipërcituar, kanë sjellë akte hetimore për hetim pasurorë vetëm Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës dhe Vlorë, por nisur nga parregullsia e sjelljes së tyre, (akte shkresore të përgjithshme në një shkesë përcjellëse dhe të paspecifikuara rast pas rasti) është kërkuar nga këto Prokurori që çdo material që do të silllet të silllet me informacion të veçantë dhe me akte shkresore të veçanta. Kjo me qëllim që nga ana jonë të realizohet dhe procedura e shortit për caktimin e prokurorëve që do të ndjekin hetimet.

Informacion statistikor mbi çështjet penale që lidhen me procesin e verifikimit të integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

Lidhur me hetimin e veprave penale që lidhen me procesin e verifikimit të integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike, rezulton se veprat e kryera nga këto subjekte nuk janë në kompetencë lëndore të kësaj prokurorie, por për vitin 2018 janë duke u ndjekur si procedime të lidhura hetimet për dy kallëzime për _____, të dërguar për kompetencë nga Drejtoria e Dekriminalizimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

Problemet e hasura në drejtimit dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit dhe veprimtarinë e punës së kësaj prokurorie.

Sa parashtruar më lart, mbi drejtimin dhe përparësinë në luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit të zyrtarëve të lartë dhe të zgjedhurve vendor si dhe në sistemin e drejtësisë, hetimit pasuror, janë evidentuar edhe problematika. Ka një mungesë bashkëpunim konstruktiv mes prokurorisë dhe strukturave të policisë, të sektorëve përkatës në nivel qendrorë si dhe me disa drejtori të policisë vendore. Mungesë e referimeve serioze për kryerjen e hetimeve proaktive për grupe të strukturuar kriminale, vepra penale të trafikimit të narkotikëve, njerëzve etj.

Mos krijimi i kushteve dhe kapaciteteve njerëzore, (Punonjësve të policisë) për aplikimit të metodave speciale të hetimit, për veprime simuluese dhe infiltrimit në përbërjen e grupeve kriminale ku evidentohet vetëm dy raste për vitin e kaluar, çfarë e bën të vështirë hetimin e aktivitetit të këtyre grupeve, ku e vetmja mënyrë e marrjes së të dhënave ngelet përgjimi i telefonave dhe me aq sa është e mundur përgjimi në vende publike dhe ndonjë rast në vende private.

Evidentohet në shifra minimale referimi i veprave penale të korrupsionit të zyrtarëve të lartë dhe të zgjedhurve vendorë me 3 referime dhe në sistemin e drejtësisë 7 referime edhe këto me mangësi në të dhëna, megjithatë shihet si një domosdoshmëri në luftën kundër këtij fenomeni mjaft shqetësues. Për këtë kategori subjektësh mungon roli aktiv i strukturave përkatëse të policisë së shtetit, për të kërkuar dhe mbledhur informacione për veprat penale të korrupsionit me qëllim regjistrimin e procedimeve penale dhe kryerjen e hetimeve proaktive.

Megjithatë e kemi ngritur si shqetësim në të gjithë analizat e punës, takime me drejtues të policisë shtetit deri tani nuk është krijuar një seksion i veçantë për korrupsionin e zyrtarëve të lartë dhe funksionarëve të drejtësisë, e cila do i përgjigjej dhe organizimit të seksionit përkatës që ka kjo prokurori për veprat penale të korrupsionit, strukturë e cila do të sillte një bashkërendim më të mirë dhe identifikimin e rezultateve konkrete për këto vepra penale duke pasqyruar rezultate vetëm për këtë kategori veprash penale.

Nuk ka organizim pune më diskret dhe të centralizuar direkt tek prokurori i hetimit, sa i përket vëzhgimit dhe përgjimit të zyrtarëve të lartë objekt hetimi, një qasje e cila nuk do të lejonte dhe do zvogëlonte numrin e personave që mund të vijnë në dijeni të këtyre hetimeve në policinë e shtetit dhe shmangte burokracitë në korespondencën mes institucioneve dhe mundësinë e nxjerrjes së sekretit hetimor.

Po ashtu edhe në drejtim të hetimit pasuror evidentohen problematika të ndryshme, pasi aktet referuese nuk plotësojnë kushtet e referimit pasuror dhe nga verifikimi nuk rezultojnë pasuri si dhe në rastin e referimeve pa u kryer paraprakisht verifikimet e nevojshme që mund të kryhen nga prokuroritë e shkallës pare në rrethe. Nuk ka një koordinim të mirë me prokuroritë e shkallës së pare në rrethe, nga të cilët pritet raportimi në kohë i rasteve që mund të jenë të suksesshme si hetime pasurore, duke raportuar në kohën e duhur rastet e vendosjes së sekuestrove preventive.

Megjithse në çdo raport analizë, një nga përparësitë është dhe përfundimi i hetimeve në një kohë sa më të shpejtë dhe brenda afateve procedurale të çështjeve të mbartura, vijon të ekzistojë e njëjta problematike me zvarritjen e hetimeve. Disa nga arësyet e zgjatjes së hetimeve janë objektive, që vijnë për shkak të vonesës në ekzekutimin e letër-porosive, analiza dhe ekspertime të ndryshme kompjuterike, tabulate telefonike, aparate telefonike, transkriptime të përgjimeve, hetimeve komplekse kur kemi të bëjmë me hetimin e grupeve të strukturuar kriminale me shumë persona në hetim ose të përfshirë në aktivitet dhe që kërkohet dokumentimi i autorësisë së tyre, e megjithatë vijon të ngelet shqetësim mungesa e një vemëndje, kontrolli kronologjik të detyrave dhe shpesh neglizhencë e prokurorëve si dhe një punë jo efçente e oficerëve të policisë gjyqësore të seksioneve dhe të shërbimeve të policisë në strukturat e policisë së shtetit.

Shpejtësia në përfundimin e hetimeve nuk ka qënë një tregues i mirë, referuar ngarkesës dhe rezultatit të çështjeve të përfunduara dhe hetuara nga secili prokuror dhe oficer i policisë gjyqësore i seksioneve në prokurori dhe i shërbimeve të policisë gjyqësore. Pothuajse pjesa më e madhe e procedimeve në hetim ka përfunduar pas një zgjatje afati të hetimeve dhe disa të tjera janë zgjatur deri në afatet maksimale të hetimit duke pasur dhe raste të zgjatjes së afateve të paraburgimit.

Në ulejn e shpejtësisë në hetime pranë kësaj prokurorie ndidkim ka patur dhe fakti që nga muaji qershor 2018, me largimin e prokurorit H.L, dhe me pas në vijimsi dhe me largimin e katër prokurorëve të tjerë duke u caktuar në detyra pranë Prokurorive të Rretheve Gjyqësore. Prokuroria e krimeve të rënda ka ushtruar veprimtarinë e saj me 5 (pesë) prokurorë më pak në organikë.

Ka një problematike të theksuar me transkriptimin e përgjimeve të zgjatura në kohë, duke mos i dhënë mundësinë prokurorit të operojë me verifikimin e fakteve që kanë dale nga përgjimet dhe të mos ketë mundësi të vendosë për zgjidhjen e çështjes në kohë të arësyeshme. Ky fakt është bërë shkak dhe për kthimin në shuma rastë të dosjeve të dërguara me kërkesë për dërgimin e çështjes në gjykim apo me këkesë për pushim, pikërisht për shkak të mostranskriptimit të plotë të përgjimeve.

Megjithse e pajustificuar konstatojmë se në tek prokurorë dhe oficerë të caktuar janë evidentuar luhajtje të angazhimit dhe vullnetit në punë si rezultat e ndryshime kushtetuese dhe ligjeve paketë e reformës në drejtësi, ku parashikohet dhe ndryshimi i funksionimit të Prokurorisë Për Krime të Rënda. Pritja për implementimin përfundimtar ka ndikuar në lidhje me pasigurinë e përfshirjes në të ardhmen në struktura të prokurorëve dhe policisë gjyqësore një ndikim i cili ka ulur vullnetin dhe efçensën në shpejtësinë e hetimeve.

Po kështu në ndryshim nga viti 2017, viti 2018 ka qënë viti ku tashmë janë ndjerë plotësisht pasojat e aplikimit të ndryshimeve që ka pësuar K.Pr.Penale në lidhje me zgjatjen e afatit të hetimeve, për shkak të procedurave të reja që duhen ndjekur për njoftimet e viktimave, përfaqësuesve të tyre, shqyrtimit të kërkesave të palëve, etju. Aplikimi i dispozita kalimtare për kompetencën e Gjykatës së Krimeve të Rënda ka pasur diskutime dhe ka ndikur në shpejtësinë e hetimit për shkak se shumë dosje janë bërë objekt dërgimesh për kompetencë në Prokuroritë e Rretheve dhe më pas rikthimi në Prokurorinë e Krimeve të Rënda për shkak të ndërhyrjes së Gjykata e Lartës së Lartë me vendim unifikues në muajin maj 2018.

II. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITATIT DHE PUNËS SË PROKURORISË VOLUMI I PUNËS NË HETIM

Duke kaluar në një analizë me shifra për treguesit e kriminalitetit dhe të punës së prokurorisë në ushtrimin e ndjekjes penale, zgjidhjen përfundimtare të çështjeve, cilësinë e zgjidhjes, evidentohet se kjo prokurori ka ushtruar ndjekjen penale, duke hetuar gjithsej 703 procedime penale, dhe - 35 procedime penale të bashkuara në total 668 çështje për vitin 2018. Nga këto kanë marrë zgjidhje 213 procedime, ndërkohë që u mbartën për vitin 2019, 455 procedime.

Ndërkohë që krahasuar me vitin 2017 ku janë mbartuar për viti 2018, 415 procedime penale - 18 të procedime penale të bashkuara (397). Gjatë vitit 2018 në regjistrin e procedimeve mbi bazë kallëzimi, referimi, kryesisht, u regjistruan 180 procedime penale + 71 procedime ardhura me transferim + 32 të ndara nga procedimet e tjera + 5 procedime të rifilluara, në total 288 çështje penale. Kjo prokurori ka ushtruar ndjekjen penale, duke hetuar gjithsej 703, - 35 procedime penale të bashkuara në total 668 çështje nga 704 çështje që janë hetuar për vitin 2017.

Nga këto kanë marrë zgjidhje 213 procedime, ndërkohë që u mbartën për vitin 2019, 455 procedime.

Për shkak të mbartjes nga vitet e kaluara të një numri të konsiderueshëm dhe atyre të regjistruara në vitin 2018, u rrit edhe numri i çështjeve të mbartura për vitin në vijim (nga 415 në vitin e kaluar, në 455 për këtë vit), ose 40 çështje penale të mbartuar më shuma se viti I kaluar. Ndikim në rritjen e numrit të procedimeve të mbartuar kanë patur, numri më I vogël i prokurorëv, ku gjysmën e vitit 2018 kjo prokurori ka patur në organikën e sajë 5 prokurorë më pak, gjë që ka sjellë zëvendësimin e dosjeve nga prokurorët e larguar tek prokurorët aktual, dhe po kështu ky është viti i plotë ku janë ndjerë në praktikë efektet e ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale hyrë në fuqi më datë 01 gusht 2017.

Për 55 kallëzime u vendos mosfillimi i procedimit, për mungesë të elementeve të faktit penal, ndërsa në përfundim të hetimeve morën zgjidhje përfundimtare 213 procedime.

Në vitin 2018 janë dërguar për gjykim 77 çështje penale nga 129 procedime penale të dërguara për gjykim në vitin 2017, u pushuan 31 procedime nga 60 procedime të pushuara në vitin 2017, u pezulluan 58 procedime në vitin 2018 nga 42 në vitin 2017, u transferuan prokurorive të tjera 47 procedime me 68 persona nën hetim, ndër të cilët 31 me masë sigurimi arrest burg për vitin 2018 nga 56 procedime penale të transferuara prokurorive të tjera në vitin 2017, me 142 persona nën hetim nga të cilat 87 me masë sigturimi arrest në burg . **(shih diagramën 2)**

Gjatë vitit 2018, u zgjatën afatet e hetimeve deri në 3 muaj për 27 procedime penale, deri në 6 muaj për 31 procedime, deri në 9 muaj 34 procedime penale, deri në një vit për 58 procedime penale dhe mbi një vit për 63 procedime penale me 65 të pandehur ndër të cilët 19 me arrest në burg, duke zgjatur kështu dhe afatet e paraburgimit për disa të arrestuar.

Numrin më të madh të çështjeve të dërguara për gjykim, sipas llojit të veprave penale e zënë me (36 çështje) dhe (86 të pandehur), trafikimi i lëndëve narkotike, me (13 çështje) me (13 të pandehur), vrasjet për shkak të marrëdhënjeve familjare, me (13 çështje) me (19 të pandehur) shtrëngimi me anë të kanosjes për dhënien e pasurisë, më radhë sipas numrit të tyre.

Nga çështjet e dërguara për gjykim, veçojmë 6 çështje me 30 të pandehur **(shih tabelën nr.6)**, të cilët krahas veprës bazë (*neneve 283/a, 109/b, 139, etj të K.Penal*) bashkëpunimin e tyre e kanë pasur në kuadër të grupit të strukturuar kriminal sipas parashikimeve të neneve 333/a dhe

334 të K.Penal. Kryesisht janë çështje të cilat kanë qënë sensitive dhe në vemëndje të opinionit publik, si çështja në ngarkim të , etj gjithsej 9 të pandehur, për veprat penale të parashikuara nga nenet 136/2, 278/1, 28/4, 333/a/1,2, 334 të K.Penal, çështjet penale, nr 12/1 dhe 12/3 të vitit 2017 të dërguara për gjykim në ngarkim të gjithsej 15 të pandehurve për vepra penale të kultivimit të parashikuara nga nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të K.Penal, çështja penale nr 313/2016 e dërguar për gjykim në ngarkim të pandehurve , etj, për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/ 284 e 28, 334 dhe 333/a të K.Penal, çështja nr 133/2016 dërguar për gjykim në ngarkim të pandehurit , për veprat penale të parashikuara nga nenet 139, 333/a dhe 334 të K.Penal, çështja penale nr 274/1 në ngarkim të , etj për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a, 287 dhe 333/a të K.Penal.

Po ashtu kanë qënë dhe çështje të tjera për vepra penale të korrupsionit të zyrtarve të lartë dhe në sistemin e drejtësisë, si p.sh çështja Gjykatës së Apelit Durës, çështja e ,si dhe çështje të tjera, me rëndësi dhe impakt, në kompetencë lëndore të kësaj prokurorie.

Ndër grupveprat penale të hetuara përgjatë vitit 2018, të mbartura dhe regjistruara (**shih tabelën 2**) ashtu si në vitin e kaluar, vazhdojnë t'a zënë krimet e trafikimit të lëndëve narkotike(282 procedime), shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë (64 procedime), trafikimi i qënieve njerëzore, i të rriturve dhe i të miturve (63 procedime), vrasje të ndryshme, sidomos vrasjet brenda familjes (32 procedime), veprat penale të korrupsionit (69 procedime), veprat e ndryshme penale të kryera nga organizata kriminale dhe grupe të strukturuar(85 procedime), trafikim i armëve dhe i municioneve (15 procedime), krimet e lidhura me terrorizmin (7 procedime), rrëmbimi i personit (8 procedime).

Ndërsa marrja për bazë e regjistrimeve te procedimeve të vitit 2018 në mënyrat e ndryshme të marrjes dijeni të njoftimit, paraqiten në shifra të larta trafikimi i narkotikëve (77 procedime) shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë 26 procedime), trafikimi i qënieve njerëzore, i të rriturve dhe i të miturve (17 procedime), vrasje të ndryshme, (14 procedime, nga këto 11 procedime janë vrasje për shkak të marrëdhënieve familjare), veprat penale të korrupsionit (42 procedime), veprat e ndryshme penale të kryera nga organizata kriminale dhe grupe të strukturuar (51 procedime), shpërdorimi I detyrës (7 procedime) trafikim i armëve dhe i municioneve (4 procedime), krimet e lidhura me terrorizmin (3 procedime), rrëmbimi i personit (1 procedim).

Gjatë vitit 2018 u vunë nën hetim 641 persona, 2 persona më shumë se gjatë vitit 2017. Nga këta, 176 u dërguan për gjykim. U pushuan hetimet ose akuzat për 18 subjekte,(31 më pak se vitin 2017) ndërsa procedimet për 68 subjekte të tjera u transferuan për kompetencë në prokuroritë e rretheve gjyqësore. Nga numri në total, ndaj 350 subjekteve janë kërkuar masa shtrënguese, 286 kërkesa për masë sigurimi arrest në burg, 28 arrest burg në mungesë dhe masa të tjera. Gjykata ka pranuar kërkesat për 279 masa sigurimi arrest në burg, për 28 në mungesë, dhe diferenca me masa të tjera sigurimi me të lehta. Në apel janë shqyrtuar 182 apeline, ku është vendosur për 165 subjekte miratimi i vendimit që pranon kërkesën e prokurorit, për 14 është ndryshuar vendimi për masa më të buta, dhe për 3 apeline është vendosur shfuqizim vendimi. Edhe në këtë rast në vlerësimin tone ka një tregues të qëndrueshëm dhe kërkesa të bazuara të prokurorit për masat e sigurimit.

Disa nga procedimet me të rëndësishme që janë hetuar me mjetë të posaçme të hetimit dhe që kanë rezultuar me zbardhjen e një numri shumë të madh të fakteve kriminale dhe arrestimin e nje nje numri të konsiderueshëm të shtetave të hetuar janë:

1. Hetimi i **procedimit penal Nr.53, të vitit 2017**, i njohur ndryshe dhe si **operacioni "One..."**, ku pas identifikimit të disa grupimeve të strukturuar kriminale që kryenin

veprat penale të parashikuara nga nenet 298, 333/a dhe 334 të K.Penal, u bë i mundur gjatë vitit 2018 caktimi i mbi 60 masave të sigurimit “arresti në burg”, për shtetas të dyshuar në këtë aktivitet kriminal.

2. Hetimi i **proçedimit penal Nr.54, të vitit 2017**, i njohur ndryshe dhe si **operacioni “P...”**, ku pas identifikimit të një grupi të strukturuar kriminal të drejtuar nga shtetasi Met Kanani, që dyshohen për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a, 333/a dhe 334 të K.Penal, u bë i mundur caktimi i mbi 15 masave të sigurimit “arresti në burg”, për shtetas të dyshuar në këtë aktivitet kriminal në muajin maj 2018.
3. Hetimi i **proçedimit penal Nr.60, të vitit 2018**, i njohur ndryshe dhe si **“Çështja B...”**, ku pas identifikimit të këtij grupi kriminal me aktivitet kryesisht në Shkodër por dhe jashtë Shqipërisë si në Belgjikë, Hollandë, etj, të dyshuar se kanë kryer veprat penale të parashikuara nga nenet 76, 78, 109/b, 333/a dhe 334 të K.Penal, u bë i mundur caktimi 9 masave të sigurimit “arresti në burg”, për shtetas të dyshuar në këtë aktivitet kriminal.
4. Hetimi i **proçedimit penal Nr.339, të vitit 2016**, i njohur ndryshe dhe si **operacioni “V...”**, ku pas identifikimit të disa grupeve të strukturuar kriminale, që dyshohen për veprat penale të parashikuara nga nenet 283/a, 333/a dhe 334 të K.Penal, u bë i mundur caktimi I 44 masave të sigurimit “arresti në burg”, për shtetas të dyshuar në këtë aktivitet kriminal.
5. Hetimi i **proçedimit penal Nr.272, të vitit 2016**, i njohur ndryshe dhe si **operacioni “Rr...”**, ku pas identifikimit të disa grupimeve të strukturuar kriminale që kryenin veprat penale të parashikuara nga nenet 298, 333/a dhe 334 të K.Penal, u bë i mundur caktimi i mbi 10 masave të sigurimit “arresti në burg”, etj, për shtetas të dyshuar në këtë aktivitet kriminal.

Nga 176 subjektet e dërguara për gjykim, pjesa më e madhe e tyre (128 persona) kanë qenë nën masën e sigurimit arrest në burg (118 në fakt dhe 10 në mungesë), 3 subjekte nën masën e arrestit në shtëpi, 26 subjekte nën masën e sigurimit detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore, 1 subjekte nën masën e sigurimit shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik, kurse 18 subjekte pa masë sigurimi. **(shih tabelen 6).**

U pushuan akuzat ose hetimet për 18 persona **(shih diagramën 4)**, nga të cilët 3 me masë sigurimi arrest në burg, 1 person arrest burg në mungesë, 1 person me masë sigurimi garanci pasurore 1 persona me masën e sigurimit detyrim për tu paraqitur në policinë gjyqësore, dhe 12 persona pa masë sigurimi (11 persona më pak se vitin e kaluar dhe 10 persona më pak me masë sigurimi arrest burg). Nga 68 personat e hetuar në procedimet e transferuara për mungesë të kompetencës lëndore 30 subjekte kanë qenë të arrestuar në fakt, 1 me masë sigurimi në mungesë, 33 subjekte kanë qenë pa masë sigurimi. **(shih tabelen 5)**

Për vitin 2019 u mbartën në hetim 192 proçedime penale me autorë, me 379 persona nën hetim, rreth 163 persona nën hetim më shumë se në vitin 2017, te cilët janë regjistruar për vepra penale të kryera në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, siç janë proçedimi penal Nr.53/2017, me mbi 60 persona nën hetim, proçedimi penal Nr.339/2016, me mbi 35 persona nën hetim, proçedimi penal Nr.272/2016, me mbi 60 persona nën hetim, etj, ku regjistrimi i emrave në regjistër apo dhe caktimi i masave të sigurimi është bërë gjatë vitit 2018. Nga këta, 245 shtetas janë me masë sigurimi “arrest në burg” apo “arrest në burg në mungesë”, ndërsa të tjerët janë me masa sigurimi të tjera dhe 88 persona pa masë sigurimi **(shih diagramën 7)**. Masat e sigurimit personal të zbatuara për personat nën hetim, krahasuar me numrin e proçedimeve dhe veprat penale të hetuara jepen **në tabelën 7**.

Nga numri i çështjeve në hetim, 86 procedime me 276 subjekte janë hetuar për grupe të strukturuar kriminale dhe organizata kriminale, ndër të cilat ka procedime të cilat janë po aq sensitive dhe me impakt të lartë në opinionin publik, siç është çështja penale e trafikimit të narkotikëve në ngarkim të grupit të kryesuar nga shtetasit etj, ku po hetohet dhe ish ministri i brëndshëm i dyshuar, tashmë dhe i akuzuar dhe përcjellur aktet për gjykim në muaji mars 2019 si i dyshuar I përfshirë në kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 283/a/2, 333/a dhe 334 të K.Penal. Çështje penale për trafikim të narkotikëve nëpërmjet pikave të kalimit kufitar në sasira të mëdha (disa tonelata), ku janë në hetim efektiv të policisë si shtetasit pjesë e grupit, si dhe efektiv dhe punënjës të pikës kufitare dhe doganore. Çështje penale, për veprat penale të kultivimit të narkotikëve ku hetohen për përfshirje në këtë veprimtari dhe drejtues dhe efektiv të policive vendore, Vlorë etj. Çështje penale për vepra penale të vjedhjes me armë dhe vjedhjes me dhunë të vlerave monetare në shumta të mëdha (procedimi penal me nr. 63 viti 2017 i bashkuar) (Procedimi penal me nr. 133 i vitit 2016) të arrestuar, . Çështja penale në ngarkim të shtetasit etj, e vrasjes së Vlore. Çështje penale të korrupsionit në sistemin e drejtësisë në nivelet e gjyqtarëve të gjykatave të apelit si dhe çështje të tjera për vepra penale të ndryshme në kompetencë të kësaj prokurorie

Hetimet pasurore në zbatim të ligjit me nr.10192 datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (ndryshuar me ligjin nr.24/2014, datë 20.3.2014, nr.70/2017, datë 27.4.2017).

Seksioni përkatës i caktuar për kryerjen e hetimit pasuror ka marrë në shqyrtim materiale referuese me origjinë nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, Drejtoria e Marredhënieve Juridiksionale me Jashtë për persona të denuar dhe të akuzuar jashtë vendit, Drejtoritë vendore të policisë, si dhe nga vetë veprimtaria hetimore e prokurorëve të seksionit përkatës dhe seksioneve të tjera në këtë prokurori. Kryesisht po bëhen verifikime dhe hetime pasurore për një numër të konsiderueshëm personash, pjesë e grupeve të strukturuar kriminale që kanë aktivitet trafikimin e narkotikëve, njerëzve, për çështjet e korrupsionit çështje të cilat janë në faza gjykimi dhe hetimi.

Për vitin 2018, janë paraqitur në gjykatë 6 kërkesa për sekuestrim, në vlera të konsiderueshme si të hollash, pasurish të luajtshme dhe të paluajtshme, ndërkohë që janë dhënë nga gjykata 7 vendime sekuestrimi me pranim kërkesë (**shih tabelën 16**). Vlera e pasurive të sekuestruara, kryesisht pasuri të paluajtshme, janë në shifra të larta.

Po ashtu gjatë vitit 2018 u paraqitën 2 kërkesë për konfiskimin e pasurive të sekuestruara si në vlera monetare, pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, ndërkohë që janë dhënë nga gjykata 5 vendime për konfiskim pasurie (**shih tabela 17**).

III. TREGUESIT STATISTIKOR 2 VJEÇAR TË VEPRAVE PENALE SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

Treguesit statistikorë, sipas strukturës së veprave penale të kodit penal, janë paraqitur hollësisht në tabelën përkatëse (shih tabelën sipas strukturës)

IV. ANALIZA E TREGUESVE TË EFEKTIVITETIT TË PUNËS SË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SHKALLËS PARË PËR KRIME TË RËNDA TIRANË

Gjatë vitit 2018 përfundoi gjykimi në shkallë të parë për 107 çështje penale me 213 të pandehur nga 129 çështje me 214 persona të akuzuar të gjykuar në vitin 2017.

Sipas grupveprave penale numrin më të madh mbajnë trafikimi i narkotikëve, prodhim dhe kultivim të narkotikëve me 58 çështje dhe 113 të pandehur nga 77 çështje me 106 të pandehur për vitin 2017, shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë me 14 çështje dhe 23 të pandehur nga 19 çështje me 30 të akuzuar për vitin 2017, vrasjet për shkak të marrëdhënieve familjare dhe të tjera me 20 çështje dhe 35 të pandehur nga 16 çështje me 20 të akuzuar në vitin 2017 dhe në vijim çështjet e tjera në numër më të vogël.

Me gjykim të zakonshëm u gjykuan 45 çështje me 84 të pandehur, kurse me gjykim të shkurtuar 62 çështje me 119 të pandehur. Raporti mes dy llojeve të gjykimeve vazhdon të mbetet me diferencë të lartë dhe prirja e të akuzuarve për të zgjedhur gjykimin e shkurtuar, përveç përfitimit në uljen e dënimit, besojmë se lidhet edhe me faktin e plotësisë së hetimeve të kryera, që lejojnë zgjidhjen e çështjes në gjendjen që janë aktet në fashikullin e prokurorit.

Vlen të theksohet se në gjykim përfunduan edhe disa prej çështjeve të cilat kanë marrë vemëndjen e opinionit publik, çështja në ngarkim të pandehurve , çështja në ngarkim të etj gjithsej 11 të pandehur, për vrasjen e në Lazart, çështja në ngarkim të një pjese të grupit “B...” të grupeve të tjera të kultivimit të narkotikëve gjatë vitit 2016 etj.

Gjithashtu, përfundoi gjykimi në apel për 68 vendime penale me 114 të pandehur dhe këto vendime penale janë ekzekutuar, në krahasim me vitin 2017 ku janë gjykuar në apel dhe u vunë në ekzekutim 91 vendime penale me 141 të dënuar. Nga vendimet penale që kanë marrë formë të prerë dhe janë ekzekutuar, janë dhënë 46 vendime penale me 76 të pandehur me procedurën e gjykimin të shkurtuar dhe 22 vendime penale me 38 të pandehur me gjykim të zakonshëm.

Gjithashtu janë ekzekutuar përveç vendime të vitit 2018 dhe 41 vendime me 77 të pandehur të viteve të mëparshme nga 44 vendime penale me 89 të dënuar të viteve të mëparshme të ekzekutuar në vitin 2017.

Gjatë vitit 2018 janë ekzekutuar vendimet duke asgjesuar lëndën narkotike të sekuestruar me komisionin përkatës për 41 vendime penale me gjithsej 1691. Kg lëndë narkotike të përbërë nga 1675 kg cannabis sativa, 13.895 kg heroinë dhe 2.2 kg kokainë. Për të gjitha vendimet e gjykatës së apelit janë vënë në ekzekutim brenda afatit ligjor duke u nxjerrë urdhërat e ekzekutimit nga prokurori. Gjatë fazës së ekzekutimit të vendimeve penale janë përfaqësuar në gjyq gjithsej 42 çështje (155 senca gjyqësore) nga 64 çështje me objekte të ndryshme gjykimi të përfaqësuar në gjykim në fazën e ekzekutimit për vitin 2017.

Theksjome se gjatë këtij viti në lidhje me kompetencat lëndore nga Gjykata e Shkallës së Parë Për Krimet e Rënda Tiranë janë dhënë dhe 30 vendime penale të tjera me shpallje moskompetence në gjykim duke i kaluar çështjet për kompetencë në Gjykatat e Shkallave të Parë të Rretheve përkatëse, pra nga gjykata këtë vit janë dhënë në total 137 vendime (107+30).

PUSHIMET NË GJYKIM. – Janë vendosur pushime të akuzës për nenin 333/a i K.Penal nga gjykata e apelit për tre vendime përkatësisht 10 dhe 4 dhe 1 person të pandehur, duke u bërë pushim i pjeshëm i akuzës hequr i grupi i strukturuar kriminal , ndërsa janë deklaruar fajtor të pandehurit për veprat penale kryesore. Theksojmë se ndryshimi është bërë vetëm në Gjykatën e Apelit pasi Gjykata e Shkallës së Parë ka vendosur sipas kërkesës së Prokurorit duke pranuar nenin 333/a të K.Penal.

PAFAJËSITË. – Gjykata e Shkallës Parë, ka dhënë pafajsi të pjeshme për disa akuza për të pandehurit , etj dhe çështja është në gjykim në gjykatën e apelit.

Gjatë vitit 2018 nuk kemi asnjë rast që të jetë dhënë pafajsi e plotë nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, Tiranë dhe kjo vlerësohet si arritje nga pafajësi e dhënë për dy të pandehur për veprat penale të parashikuara nga nenet 300 dhe 109/b i K.Penal në vitin 2017.

Gjykata e Apelit për Krimet e Rënda për vitin 2018 ka dhënë dy pafajësi njëri për shtetasin , neni 260 e 25 i K.Penal dhe një vendim me tre të akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 283/a/2 i K.Penal.

Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, janë ankimuar 5 çështje themeli, nga të cilat në një rast është hequr dorë nga Prokuroria e Apelit për Krimet e Rënda, ndërsa në rastet e tjera janë përkrahur ankimet.

NDRYSHIMET E CILËSIMIT JURIDIK TË VEPRËS.

– Është ndryshuar cilësimi juridik i veprës për:

- 1- 2 të pandehur nga më e rëndë në më të lehtë, nga neni 283/a/2 në 300 të K.Penal (ndryshimi i cilësimit juridik është bërë në shkallë të parë dhe lënë në fuqi në apel për një rast ndërsa në rastin tjetër ndryshimi i cilësimit juridik është bërë vetëm në apel) ,
- 2- Për 5 të pandehur nga neni 245 e 25 i K.Penal, në nenin 244 e 24 të K. Penal, në Gjykatën e Apelit, ndërsa Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda ka vendosur sipas kërkesës së Prokurorit.për veprat penale të parashikuar nga neni 300 në 110/a/4 dhe 283/a/1 në 283/a/2 dhe 230 në 90/2 i K.Penal.
- 3- Janë dhe tre ndryshime të cilësimit juridik në gjykim në shkallën e parë nga neni 79/dh në nenin 76 dhe nga neni 109/b në nenin 277 të K.Penal, të cilat janë ankimuar dhe ndodhen në gjykim në gjykatën e Apelit.
Për një rast të ndryshimit të cilësimit juridik nga neni 283/a i K.penal në nenin 283 të tijë dhe aplikim të nenit 59 të K.Penal nga Gjykata e Shkallës së Parë, Tiranë, prokurori nuk ka ankimuar vendimin e gjykatës megjithëse kërkesa e tijë ka qenë e ndryshme nga vendimi i gjykatës .

Gjithsesi mund të themi që në tërësi këto raste nuk çenojnë cilësinë e përgjithme të zgjidhjes për një numër të lartë të pandehurish të gjykuar në vitin 2018.

U mbartën në fazën e gjykimit në shkallë të parë për vitin 2019, 59 çështje me 135 të pandehur nga 61 çështje me 160 persona të pandehur të mbartur në vitin 2018.

V. TË DHËNA LIDHUR ME MARRËDHËNJET JURIDIKSIONALE ME JASHTË

Në këtë drejtim është për t'u theksuar se ekzekutimi i letër-porositë të kërkuara nga jashtë kanë një dinamikë veprimesh njëlloj me hetimin e një procedimi të zakonshëm në këtë prokurori, duke kërkuar kështu angazhim të prokurorve dhe policisë gjyqësore. Për vitin 2018 janë trajtuar 37 kërkesa nga jashtë për ekzekutim nga 31 të trajtuara në vitin 2017. Janë ekzekutuar gjithsej 16 lëterporosi dhe kanë mbetur pa u ekzekutuar 21 të cilat janë akoma në fazën e ekzekutimit. Është kërkuar ndihmë juridike me anën e 62 letër-porositë në drejtim të autoriteteve të huaja, ku janë ekzekutuar 16 prej tyre dhe për 46 akoma nuk kemi të dhëna për ekzekutimin e tyre. Siç kemi theksuar dhe më lart, në këtë drejtim rol të rëndësishëm ka Drejtoria e marrëdhënieve me jashtë në Prokurorinë e Përgjithshme, duke koordinuar me zyrat homologe për mundësinë e ekzekutimit sa më shpejt të tyre.

Vendet nga janë bërë kërkesa për ekzekutim letërprosie janë Italia, Gjermania, Franca, Turqia, Belgjika, Holanda, Britania e Madhe, Spanja, USA, Hungari, Greqia, Mali I Zi, Zvicër dhe Kosovë.

Në 5 lëtrëporosi të ekzekutuara, sipas kërkesës së autoriteteve të huaja, gjykata ka pranuar kërkesën që në kryeren e veprimeve në Shqipëri të marin pjesë përfaqësues të autoriteteve gjyqësore të huaja, Oficerë të Policisë Gjyqësore, Prokurorë dhe Gjyqtar. Në këto raste përfaqësuesit e autoriteteve të huaja gjyqësore kanë marrë pjesë në kryerjen e veprimeve hetimore në Shqipëri si kontrollë banesash dhe pyetje të personave me cilësinë e dëshmitarit ose person nën hetim.

Gjatë vitit 2018 është udhëruar shpallja e kërimit ndërkombëtar për të dënuar dhe me masë sigurimi, gjithsej për 43 shtetas nga këto 31 shtetas me masë sigurimi dhe 12 shtetas të dënuar.

Nuk është përpiluar asnjë kërkesë për njohjen e ekzekutimit të vendimit penal të shtetit shqipëtar për vitin 2018 nga një rast i shqyrtuar në vitin 2017, janë ekstraduar nga jashtë 6 shtetas të dënuar nga 4 shtetas për vitin 2017, ndërsa janë hequr nga kërkiti ndërkombëtar 11 shtetas të dënuar (për shkak të ekzekutimit të vendimit të dënimeve për të dënuarit në mungesë, nëpërmjet ekstradimit, për shkak të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit) nga 5 shtetas për vitin 2017. Janë transferuar për jashtë shtetit për të vuajtur pjesen e mbetur të dënimit 5 shtetas nga 4 shtetas të transferuarnë vitin 2017.

VI. TË DHËNAT PËR NGARKESËN E PUNËS PËR SECILIN PROKUROR DHE OFICER TË POLICISË GJYQËSORE

Ngarkesa e prokurorëve, dhe oficerëve të policisë gjyqësore janë të paraqitura në tabelën 7, bashkëngjitur këtij raporti. Vlen të theksohet se disa nga oficerët e policisë gjyqësore kanë tregues të mire si në dinamikën e veprimeve hetimore dhe në përfundimin e veprimeve si dhe në cilësinë e sugjerimeve për zgjidhjen e çështjeve, ndërsa vihet re se disa nga oficerët pavarësisht se janë urdhëruar për kryerjen e veprime hetimore dhe kanë dinamike çështjes në hetim, kanë relatuar përfundimin e çështjeve në shifra minimale, çfarë tregon për një efiçense në nivele shumë të dobëta në punë.

VII. INFORMACION MBI ADMINISTRIMIN E PROKURORISË

Ne mbështetje të Ligjit nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, sipas urdherit 32, datë 31.01.2017 “Për miratimin e rregullorës standarte të organizimit dhe funksionimit të Prokurorive të Juridiksionit të Përgjithshëm, dhe urdherit Nr. 4, datë 20.02.2017 “Për miratimin e rregullorës së organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë Pranë Gjykatës Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë”, të Ligjit Nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”,

Në funksion të organizimit të punës së administratës (personelit administrativo-teknik) në përputhje me mënyrën e organizimit dhe funksionimin sipas strukturës organike, në Prokurorinë Pranë Gjykatës Shkallës Parë për Krime të Rënda Tiranë: Sqarojme se:

Buxheti i Prokurorisë: është realizuar sipas udhëzimeve të Prokurorisë së Përgjithshme si dhe mbështetur në Ligjin 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.4 datë 29.02.2016 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2016-2018”. Në hartimin e kërkesave për

secilin zë të shpenzimeve operative, kemi realizuar situacionin e shpenzimeve të vitit 2018 në masën 99 % , duke minimizuar çdo lloj shpenzimi të tepërt.

Marrëdhëniet me median dhe publikun: Me urdhër përkatës të Drejtuesit të Prokurorisë është ngritur dhe struktura përkatëse për marrëdhënjet me Mediat dhe Publikun. Këto marrëdhënie kanë qënë gjithnjë tepër transparente në lidhje me informimin e publikut dhe medias për veprimtarinë e prokurorisë, si dhe për çështje të veçanta, duke zbatuar rigorozisht kërkesat ligjore për garantimin e sekretit dhe mbarëvajtjes së hetimit, duke respektuar parimin për të drejtën e informimit dhe sigurisht duke i kushtuar vëmendje mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë.

Rregullsia e mbajtjes së regjistrave: Në rregullorën e Prokurorisë janë përcatuar zyrat dhe punonjësit që mbajnë regjistrat e ndryshëm të dokumentimit të punës në këtë prokurori. Në mënyrë të vazhdueshme është mbikqyrur me përpikmëri, vazhdimësi e seriozitet të lartë nga Drejtuesi i Prokurorisë, duke qënë burimi i përpilimit të statistikave të punës rezultative në vite të Prokurorisë si dhe i dokumentimit të punës në tërësi. Vazhdon të mbetet problematikë dhe për vitin 2018 fakti që në shumë raste evidentohen mungesa të raportimeve të prokurorëve tek zyrat e regjistrat për të dhëna që duhet të hidhen në regjistrë (urdhëra regjistrimi procedimi dhe emri, ndryshime akuzash dhe cilësimi juridik të veprës, vendimet për përgjimet e kryera si dhe akte të tjera të cilat i shërbejnë dokumentimit të punës së secilit prokuror dhe prokurorisë në tërësi).

Respektimi i disiplinës në punë dhe etikës nga të gjithë punonjësit: Ka vijuar të jetë gjithmonë në standartet e kërkuara, kjo si rezultat i kërkesës dhe llogaridhënies si dhe ndërgjegjjes që i karakterizon Prokurorët, Oficerët e Policisë Gjyqësore dhe Sektorit mbështetës të administratës. Në disa raste janë vërejtur shkelje të disiplinës, kryesisht tek punonjësit e administratës ndaj të cilëve janë marrë dhe masat përkatëse, sipas legjislacionit përkatës që rregullon dhe normon punën e tyre.

Kapaciteti infrastrukturor dhe siguria edhe pse nuk kanë qënë përherë në sintoni me njëra-tjetrën, stafi i Prokurorisë është përpjekur për mbarëvajtjen e sistemimit të punonjësve me të gjitha kapacitetet e mundshme, me ndihmë sigurisht edhe të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

VIII. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN PASARDHËS DHE REKOMANDIME.

Mbetemi të angazhuar për përmbushjen me korrektësi të detyrave kushtetuese dhe ligjore, duke nxitur përmirësimin dhe përsosmërinë e mëtejshme në rritjen e efektivitetit dhe cilësisë në ushtrimin e ndjekjes penale, mbrojtjen dhe përfaqësimin e akuzës në gjykim, ku prioritet i vazhdueshëm është intensifikimi i ushtrimit të ndjekjes penale për veprat penale të krimit të organizuar, korrupsionit dhe hetimi pasuror në kuadër të ligjit me nr.10192 datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (ndryshuar me ligjin nr.24/2014, datë 20.3.2014, nr.70/2017, datë 27.4.2017),

Nxitja e vazhdueshme dhe bashkëpunimi me strukturat ligjzbatuese në vënd si dhe rritja e bashkëpunimit në shkëmbimin e të dhënave dhe informacioneve në hetimet e përbashkëta me prokuroritë e vendeve tjera. Duke pasur parasyshë treguesit në rritje të trafikimit të narkotikëve kryesisht me Italianë, mundësinë e nënshkrimit të marrëveshjeve të tjera për krijimin e skuadrave të përbashkëta hetimore. Zgjerimi i hetimeve proaktive dhe të gamës së metodave të posaçme të hetimeve në goditjen e krimit të organizuar si dhe rritjen cilësore të rezultateve në drejtim të identifikimit dhe konfiskimin e pasurive me origjinë kriminale.

Rritja e cilësisë në bashkëpunimin me autoritetet e huaja gjyqësore nëpërmjet ekzekutimit të menjëhershëm dhe me cilësi të gjithë kërkesave për kryerjen e veprimeve në Shqipëri, në bashkëpunim të plotë dhe në kohë reale me këto autoritete me qëllim rritjen e efikasitetit në gjetjen dhe marrjen e provave të kërkuara.

